

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: AGROEKONOMI

Programi: Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

**Impakti i faktorëve social në rritje ekonomike - vendet e Europës
Juglindore**

Mentore:

Prof.Asoc.Dr. Jehona Shkodra

Kandidat/ja:

Agnesa Blakaj

Prishtinë, 2021

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: AGROEKONOMI

Programi: Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

**Impakti i faktorëve social në rritje ekonomike - vendet e Europës
Juglindore**

Mentore:

Prof.Asoc.Dr. Jehona Shkodra

Kandidat/ja:

Agnesa Blakaj

Prishtinë, 2021

Deklaratë për punimin

Unë Agnesa Blakaj, e lindur më datë 06.12.1997 në Pejë si studente e masterit në Departamentin e “AGROEKONOMISË”, drejtimi ‘’Ekonomi e Bujqësisë dhe Ushqimit’’, nën përgjegjësinë time të plotë deklaroj se ky punimi i masterit me titull: “Impakti i faktorëve social në rritje ekonomike - vendet e Europës Juglindore” është rezultat i punës time origjinale dhe është punuar personalisht nga unë. Asnjë pjesë e këtij punimi nuk është marr nga dikush tjetër pa qenë e cituar sipas standardeve të citimit. Një hulumtim i tillë nuk është prezantuar apo botuar para një institucioni më parë. Ky hulumtim është dizajnuar duke u bazuar në literaturën dhe burimet e cituara në punim. Andaj vetëm unë mbajë përgjegjësi personale deri në anulim të titullit të fituar në bazë të mbrojtjes së këtij punimi. Përgjegjësi për plagjiaturë në asnjë formë nuk mbajnë institucioni dhe anëtarët e komisionit.

Deklaratën e nënshkruaj në prezencë të personit zyrtar.

Prishtinë,

Data _____

Nënshkrimi i kandidatit/es _____

PËRMBAJTJA

Deklaratë për punimin.....	5
PËRMBAJTJA.....	6
ABSTRAKT	9
ABSTRACT.....	10
Lista e figurave	11
Lista e tabelave	12
Lista e shkurtesave.....	13
Kapitulli 1: Hyrje.....	1
1.1.Sfondi i studimit dhe problemit	3
Kapitulli 2: Rishikimi i literaturës	4
2.1. Ndikimi demografik në rritjen ekonomike	5
2.1.1. Teoria “pesimiste”: Rritja e popullsisë e kufizon zhvillimin ekonomik.....	6
2.1.2. Teoria “optimiste”: Ndryshimi i popullsisë mund të nxisë rritjen ekonomike	8
2.1.3. Teoria “neutrale”: Ndryshimi i popullsisë nuk ka efekt të rëndësishëm në rritjen ekonomike.....	9
2.2. Ndikimi kulturor në rritjen ekonomike	10
2.3. Statistikat mbi zhvillimet sociale dhe ekonomike në Kosovë dhe vendet tjera të EJT-së	12
2.3.1. Puna dhe Punësimi në vendet e EJT-së.....	14
2.3.2. Varfëria në vendet e EJT-së.....	19
2.3.3. Arsimi në vendet e EJT-së	25

2.3.4. Demografia në vendet e EJJL-së	31
Kapitulli 3: Metodologjia e studimit	35
Kapitulli 4. Rezultatet e pritshme, pyetjet hulumtuese dhe objektivat e studimit	36
4.1. Rezultatet e pritshme.....	36
4.1.1. Hipotezat e studimit	36
4.2. Pyetjet hulumtuese të studimit	37
4.3. Objektivat e studimit.....	37
Kapitulli 5: Rezultatet e studimit	38
Kapitulli 6: Përfundime dhe rekomandime.....	41
Referencat	45

FALENDERIME

Punimi i temës së diplomës kërkon shumë mund dhe përkushtim të madh dhe nuk do të mund të realizohej pa përkrahjen e njerëzve më të dashur, prandaj ju jam përjetë mirënjohëse dhe i falënderoj pafund të gjithë ata që më kanë mbështetur jo vetëm tani, por për gjatë gjithë rrugëtimit tim studentor.

Së pari dëshiroj të falënderoj udhëheqësen time Prof.Asoc.Dr. Jehona Shkodra, ekspertiza e së cilës ishte jashtëzakonisht e çmueshme. Mbështetja e saj ishte forcë shtytëse ndaj çdo lloj situatë e sidomos atyre sfiduese që t'i tejkaloja me lehtësi.

Dëshiroj të falënderoj poashtu të gjithë profesorët dhe kolegët, të cilët i dhanë kuptim këtij rrugëtimi.

Një ndjenjë e veçantë mirënjohjeje për prindërit e mi të dashur, shembujt e mirë të të cilëve më kanë mësuar të punoj shumë për gjërat që aspiroj të arrijë. Të gjitha sukseset e mia ju dedikohen juve!

FALEMINDERIT! Jam vërtet mirënjohëse që ju kam në jetën time!

ABSTRAKT

Ky punim analizon marrëdhëniet midis faktorëve social dhe rritjes ekonomike. Për të paraqitur gjendjen e ekonomisë së Europës Juglindore dhe përgatitjen e këtij punimi është bërë hulumtim sekondar në historikun e disa tregueseve kyç, duke përdorur të dhënat e fundit të publikuara, përfshirë: bruto produktin vendor, rritjen ekonomike, statistikat e punësimit, arsimimit, varfërisë e demografisë. Për secilin nga këta tregues është analizuar ndikimi i tyre në zhvillimin e ekonomisë së EJT-së. Punimi është realizuar duke u mbështetur në të dhënat e disponueshme nga raporte të ndryshme vjetore, punime shkencore, materiale dhe statistika të ofruara nga institucionet relevante.

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe zhvillimi social janë të lidhura ngushtë. Prandaj, qëllimi i këtij punimi është të tregojë sfidat me të cilat përballet ekonomia e vendeve të rajonit gjatë viteve të zhvillimit. Përveç kësaj, shpjegon dhe mundësitë për zhvillim të mëtejshëm përmes faktorëve social, të cilët mund të kontribuojnë në përmirësimin dhe zhvillimin e gjendjes shoqërore-ekonomike të EJT-së. Rezultatet e punimit zbulojnë faktorët social që lidhen pozitivisht me rritjen ekonomike (d.m.th. pagën mesatare dhe vitet e pritura të shkollimit) dhe, përkatësisht, faktorët që lidhen më pak me rritjen ekonomike.

Fjalët kyçe: faktorë social, rritje ekonomike, Europa Juglindore.

ABSTRACT

This paper analyzes the relationship between social factors and economic growth. In order to present the state of the economy of Southeast Europe and the preparation of this paper, a secondary research has been done in the history of some key indicators, using the latest published data, including: gross domestic product, economic growth, employment statistics, education, poverty of demography. For each of these indicators, their impact on the development of the SEE economy has been analyzed. The paper is based on data available from various annual reports, scientific papers, materials and statistics provided by relevant institutions.

Sustainable economic development and social development are closely linked. Therefore, the purpose of this paper is to show the challenges faced by the economy of the countries of the region during the years of development. In addition, it explains the possibilities for further development through social factors, which can contribute to the improvement and development of the socio-economic situation of the SEE. The results of the paper reveal the social factors that are positively related to economic growth (i.e. the average salary and the expected years of schooling) and, respectively, the factors that are less related to economic growth.

Keywords: social factors, economic growth, Southeast Europe.

Lista e figurave

Figura 1: Gjuhët më të folura në botë, 2019	11
Figura 2: Shkalla e punësimit, ndryshimi në % 2020-2021, 15+ vjet	16
Figura 3: Shkalla e pasivitetit, 15+ vite, ndryshimi në përqindje 2021-21	17
Figura 4: Shkalla e papunësisë, 15+ vite, ndryshimi në përqindje 2020-21	17
Figura 5: Koeficienti i Ginit për shtetet e EJL	24
Figura 7: Struktura e popullsisë, vendet e Ballkanit Perëndimor, 2018.....	31
Figura 6: Popullsia në moshë pune (15-64 vjeç) nga 2017 në 2018, ndryshimi në %	32
Figura 8: Lindjet dhe Vdekjet në Mal të Zi (në mijëra), 1990-2020.....	33
Figura 9: Lindjet dhe Vdekjet në Maqedoninë e Veriut (në mijëra), 1960-2020.....	33
Figura 10: Lindjet dhe Vdekjet në Serbi (në mijëra), 1995-2020.....	33
Figura 11: Lindjet dhe Vdekjet në Shqipëri (në mijëra), 1960-2020.....	33
Figura 12: Lindjet dhe Vdekjet në Kosovë (në mijëra), 1960-2020.....	33
Figura 13: Lindjet dhe Vdekjet në Bosnje dhe Hercegovinë (në mijëra), 1960-2020	33

Lista e tabelave

Tabela 1:	Parashikimi i rritjes së popullsisë deri në vitin 2050	7
Tabela 2:	BPV për kokë banori në vendet e rajonit gjatë vitit 2017, 2020.....	13
Tabela 3:	Rritja e punësimit në %, 2017.....	15
Tabela 4:	Parashikimet për varfërinë në %, 2016-2022.....	21
Tabela 5:	Indeksi i Kapitalit Njerëzor për EJL, 2020	29
Tabela 6:	Variabla e varur dhe variablat e pavarura të modelit.....	38
Tabela 7:	Korrelacioni	38
Tabela 8:	Model Summary.....	39
Tabela 9:	Fit Regression Model.....	40

Lista e shkurtesave

BPV – Bruto Produkti Vendor

EJL – Europa Juglindore

BE – Bashkimi European

BP – Ballkani Perëndimor

PZHKB – Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

HCI – Indeksi i Kapitalit Njerëzor

ALB – Shqipëria

KOS – Kosova

MKD – Maqedonia

MNE – Mali i Zi

SRB – Serbia

Kapitulli 1: Hyrje

Asnjë nga temat ekonomike nuk tërheq vëmendjen e ekonomistëve, si koncept i rritjes ekonomike. Rritja ekonomike mund të përkufizohet si një ndryshim pozitiv në nivelin e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara nga një vend gjatë një periudhe kohe të caktuar. Një karakteristikë e rëndësishme e rritjes ekonomike është se ajo nuk është kurrë uniforme ose e njëjtë në të gjithë sektorët e një ekonomie (Nitisha, n.d.) Përcaktuesit e rritjes ekonomike janë faktorë të ndërlidhur që ndikojnë në normën e rritjes së një ekonomie (Boldeanu & Condrantinescu, 2015). Disa nga faktorët e rëndësishëm që ndikojnë në rritjen ekonomike të një vendi: burimet njerëzore, burimet natyrore, formimi i kapitalit, zhvillimi teknologjik dhe faktorët social. Sipas Harrison dhe Huntington (Culture Matters, 2000), analiza e faktorëve social ndihmon në kuptimin e sjelljes njerëzore në lidhje me konsumin, kursimet, sistemin e investimeve, pritjet dhe qëndrimin ndaj rrethanave ekonomike, të cilat gjithashtu kanë një ndikim të madh në rritjen ekonomike. Hulumtimet e fundit ekonomike dhe sociologjike kanë sugjeruar rëndësinë e kapitalit social si një përcaktues i performancës ekonomike.

Sipas statistikave të Fondit Monetar (World Economic Outlook), rritja ekonomike paraqitet në nivele të ndryshme në vende të ndryshme. Ndërsa vendet e zhvilluara ekonomike kanë një rritje ekonomike në nivele të ulëta, vendet në zhvillim ekonomik kanë një nivel të lartë rritje. Por, ky fakt nuk tregon se niveli i lartë i rritjes është më i mirë se niveli i ulët, pasi vendet kanë histori të ndryshme të ekonomisë dhe ritme të ndryshme të zhvillimit të saj.

Perspektiva ekonomike afatmesme për Europen Juglindore paraqitet pozitive, por ajo mbetet objekt i rreziqeve që rrjedhin nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm (përfshirë edhe ato politike). Për të ruajtur dhe mbështetur rritjen ekonomike kërkohet angazhim i vazhdueshëm me qëllim uljen e disbalancave fiskale dhe zbatimin e reformave strukturore (Vostroknutova & Hernandez, 2017).

Koncepti i zhvillimit social përfshin të paktën tre konotacione të zhvilluara në literaturën sociologjike. Në formën e tij më themelore, ai përkufizohet thjesht si përmirësim

i standardit të jetesës së një popullsie. Një qasje e dytë, ndërkohë që pranon se ekonomia përbën një faktor të fuqishëm në zhvillimin shoqëror, thekson shpërndarjen e pasurisë. Një perspektivë e tretë, më pak ekonomike, e identifikon zhvillimin shoqëror me diferencimin shoqëror që rrjedh nga transformimet kapitaliste dhe industriale që i dhanë lindje botës moderne (Baltes & Smelser, 2001). Zhvillimi social është një proces që përfshin të gjitha nivelet e institucioneve, nga qeveritë kombëtare deri te organizatat e ndryshme të shoqërisë civile, për të ndërtuar një shoqëri të barabartë dhe të drejtë përmes ndarjes së mundësive ekonomike dhe shërbimeve sociale duke adresuar mosbalancimin e pushtetit (Department of Economic and Social Affairs, 2005). Zhvillimi social përdor dhe/ose ndryshon proceset e institucioneve dhe sistemeve shoqërore, nëpërmjet politikave dhe programeve, për të forcuar aftësitë dhe kapacitetet e individëve, familjeve dhe komuniteteve (Drolet & Sampson, 2017). Kapitali social ka tre dimensione. Së pari, ai zëvendëson tregjet dhe institucionet, veçanërisht në ekonominë në zhvillim. Së dyti, ai plotëson tregjet dhe institucionet. Së treti, ai mund të jetë një bazë e drejtpërdrejtë për mirëqenien. Balancimi më i mirë midis implikimeve ekonomike dhe përfitimeve të drejtpërdrejta të kapitalit njerëzor dhe social mund të jetë i ndryshëm në vende të ndryshme, në varësi të kulturës dhe historisë (Omori, 2013).

1.1.Sfondi i studimit dhe problemit

Studimi i teorisë së rritjes ekonomike është një proces shumë kompleks që ka evoluar në shumë dekada dhe shekuj (Boldeanu & Constrantinescu, 2015).

Për shekuj me radhë është menduar se mirëqenia e shtetit bazohet vetëm në nivelin e të ardhurave, kështu vazhdimisht janë përqëndruar në rritjen e të ardhurave kombëtare. Ky punim spjegon nevojën që një shoqëri duhet të mbështesë zhvillimin njerëzor (që matet nga “Treguesi i Zhvillimit Njerëzor”) duke pasur parasysh që për një periudhë afatgjate, më shumë përfitime ekonomike ka prej zhvillimit njerëzor.

Ndërkohë që ka gjithmonë një hendek në rezultatet e arsimit ndërmjet individëve me prejardhje të ndryshme socio-ekonomike, hendeku zgjerohet në vendet me pabarazi të lartë, ndërsa njerëzit në familjet e pafavorizuara luftojnë për të hyrë në arsim cilësor. Kjo nënkupton sasi të mëdha të potencialit të humbur dhe lëvizshmëri më të ulët sociale (OECD, 2015), kështu, në këtë punim spjegohet nevoja që vendet duhet të përqendrohen më shumë në zhvillim social në mënyrë që të arrijnë rritje ekonomike. Përmes këtij punimi spjegohet poashtu nevoja e investimit në kapitalin njerëzor, sepse ky investim çon në zhvillim të qëndrueshëm dhe mundëson arritjen e standardeve më të larta të jetesës.

Kapitulli 2: Rishikimi i literaturës

Sipas një analize ekonometrike të realizuar nga (Popa, 2012) për Rumaninë dhe vendet e BE-së rezulton se faktorët që lidhen pozitivisht me rritjen ekonomike janë vitet e pritura të shkollimit dhe jetëgjatësia dhe, përkatësisht, faktorët që lidhen negativisht me rritjen ekonomike janë popullsia në rrezik të varfërisë dhe shkalla e papunësisë. Autori poashtu shton se investimi i vazhdueshëm në kapitalin njerëzor çon në zhvillim të qëndrueshëm dhe duhet të konsiderohet brenda politikave ekonomike si një nga objektivat themelore të çdo vendi që dëshiron të arrijë standarde të larta të jetesës dhe mirëqenies ekonomike. Investimi në kapitalin njerëzor, aksesit dhe afërsia me zonat urbane janë të dobishme për rritjen ekonomike të shteteve (Rupasingha, et al., 2002).

Sipas (Boldea, 2012) kombet me një përqindje të lartë të fëmijëve ka të ngjarë të kushtojnë një pjesë të madhe të burimeve për kujdesin e tyre, dhe kjo ka tendencë të ngadalsojë ritmin e rritjes ekonomike. Në të kundërt, nëse shumica e popullsisë së një kombi është në moshë të punës, produktiviteti i shtuar i këtij grupi mund të prodhojë rritje ekonomike. Për më tepër, nëse një pjesë e madhe e popullsisë së një kombi përbëhet nga të moshuarit, efektet mund të jenë të ngjashme me ato të një popullate shumë të re: një pjesë e madhe e burimeve është e nevojshme nga një segment relativisht më pak produktiv i popullatës, i cili gjithashtu mund të frenojë rritjen e ekonomisë.

Mahmoud A. Al-Habees dhe Mohamed Abu Rumman (Al-Alhabees & Rumman, 2012) tregojnë se ekziston një lidhje e rëndësishme midis rritjes ekonomike dhe ndryshimit të niveleve të papunësisë në Jordani dhe në disa vende arabe. Mirëpo, ata poashtu shtojnë se lidhja midis rritjes ekonomike dhe shkallës së papunësisë nuk është e fortë siç konfirmohet nga analiza teorike. Sepse, çuditërisht, vendet me shkallë të lartë të papunësisë janë ato me ritme pozitive të rritjes ekonomike.

Lidhja midis pagës dhe rritjes ekonomike është një proces shumë kompleks. Dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth marrëdhënies midis tyre. Disa studime zbulojnë një lidhje pozitive midis pagës dhe rritjes ekonomike, ndërsa të tjera gjejnë lidhje negative (Xu, et al., 2015).

Në një studim të realizuar nga (Erić, 2018) analizohet lidhja midis arsimit, sistemit arsimor dhe rritjes ekonomike për vendet e Ballkanit Perëndimor. Rezultatet e këtij studimi kanë treguar se Maqedonia ka arsimimin me strukturë më të favorshme në vendet e BP, me pjesëmarrje më të lartë të popullatës së arsimuar në universitet. Më pas rradhitet Kroacia, Mali i Zi dhe Serbia. Shqipëria është në pozicionin e parafundit midis grupit të vendeve me 12% të popullsisë së arsimuar në universitet. E fundit me numër të popullsisë së arsimuar në universitet dhe numrin e përgjithshëm të popullsisë në moshë pune është Bosnja dhe Hercegovina. Rezultatet e analizës së korrelacionit të këtij studimi tregojnë se ekziston një lidhje e fortë midis arsimit të lartë dhe BPV-së për kokë banori, d.m.th., popullsia e arsimuar në universitet është shumë e rëndësishme për nivelin e zhvillimit ekonomik, poashtu ekziston lidhje inverze midis njerëzve me arsim joformal dhe zhvillimit ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor.

2.1. Ndikimi demografik në rritjen ekonomike

Për dekada, ekonomistët dhe mendimtarët socialë kanë debatuar mbi ndikimin e ndryshimit të popullsisë në rritjen ekonomike. Tre pozicione alternative përcaktojnë këtë debat: se rritja e popullsisë kufizon, nxit ose është e pavarur nga rritja ekonomike. Përkrahësit e secilit shpjegim mund të gjejnë dëshmi për të mbështetur rastet e tyre. Të gjitha këto shpjegime, megjithatë, përqendrohen në madhësinë dhe rritjen e popullsisë (Bloom, et al., 2001).

Vitet e fundit, megjithatë, debati ka nën-theksuar një çështje kritike, strukturën e moshës së popullsisë (që është, mënyra në të cilën shpërndahet popullsia në grupmosha të ndryshme), e cila mund të ndryshojë në mënyrë dramatike me rritjen e popullsisë. Për shkak se sjellja ekonomike e njerëzve ndryshon në faza të ndryshme të jetës, ndryshimet në strukturën e moshës së një vendi mund të kenë efekte të rëndësishme në performancën e tyre ekonomike. Kombet me një përqindje të lartë të fëmijëve ka të ngjarë të kushtojnë një pjesë të madhe të burimeve për kujdesin e tyre, gjë që tenton të ulë ritmin e rritjes ekonomike. Në të kundërt, nëse shumica e popullsisë së një kombi bie brenda moshave të punës, produktiviteti i shtuar i këtij grupi mund të prodhojë një "divident demografik" të

rritjes ekonomike, duke supozuar se ekzistojnë politika për të përfituar nga kjo (Bloom, et al., 2001).

Ndryshimi i strukturave të moshës së popullsisë po formon trajektoret e zhvillimit në shumë vende, duke sjellë mundësi dhe sfida. Ndërsa plakja ka qenë një çështje shqetësuese për ekonomitë me të ardhura të mesme dhe të larta, rritja e shpejtë e popullsisë do të vazhdojë në vendet më të varfra edhe në dekadat e ardhshme (Cruz & Ahmed, 2018).

Faktorët demografikë ndonjëherë kanë zënë qendrën në diskutimin e burimeve të rritjes ekonomike. Në shekullin e 18 -të, Thomas Malthus bëri parashikimin pesimist se rritja e PBB -së për frymë do të binte për shkak të një rritje të vazhdueshme të shpejtë të popullsisë botërore (Jinill, 2016).

2.1.1. Teoria “pesimiste”: Rritja e popullsisë e kufizon zhvillimin ekonomik

Pas Luftës së Dytë Botërore, rritja e shpejtë e popullsisë, që rezulton nga hendeku midis rënies së vdekshmërisë dhe vazhdimit të pjellorisë së lartë, filloi të ndodhte në pjesën më të madhe të Azisë. Nga mesi i viteve 1960, më shumë vende, duke përfshirë një numër në Amerikën Latine dhe Lindjen e Mesme, po përjetonin ritme të paprecedentë të rritjes së popullsisë. Me ritme të tilla, popullsia e tyre do të dyfishohej në më pak se 25 vjet. Shqetësimet për rritjen e shpejtë të popullsisë të shprehur nga demografët, shkencëtarët socialë dhe të tjerë u bazuan kryesisht në supozimin se një rritje e tillë do të "shërbente si një frenim në zhvillimin ekonomik". Në fund të viteve 1940, konservatorët filluan të shkruajnë për rritjen e tepërt të popullsisë që ishte një kërcënim për furnizimet ushqimore dhe burimet natyrore.

Popullsia e botës është rritur gjashtëfish që nga viti 1800, kur ishte rreth një miliard. U deshën më pak se 130 vjet për të shtuar një miliard të tjerë. Gjërat janë përshpejtuar në mënyrë të konsiderueshme që nga ajo kohë. Foshnja e 6 miliardë lindi në tetor 1999 dhe popullsia botërore parashikohet të jetë 9.3 miliard njerëz deri në vitin 2050.

Tabela 1: Parashikimi i rritjes së popullsisë deri në vitin 2050

Parashikimet	Vitet
1 miliard	Viti 1804
2 miliard	Viti 1927
3 miliard	Viti 1960
4 miliard	Viti 1974
5 miliard	Viti 1987
6 miliard	Viti 1999
7 miliard	Viti 2012
8 miliard	Viti 2026
9 miliard	Viti 2043

Source: Population Division, Department of Economic and Social Affairs, UN Secretariat. Population Newsletter No 66, December 1998; and United Nations, World Population Prospects: The 2000 Revision

Shqetësimet për ndikimin e rritjes së shpejtë të popullsisë dhe fertilitetit të lartë janë në themel të zbatimit të gjerë të programeve të planifikimit familjar në shumë fusha të vendeve në zhvillim. botë. Politikëbërësit supozuan se duke ndihmuar në uljen e pjellorisë së lartë, programet e planifikimit familjar do të ngadalësonin rritjen e popullsisë, e cila nga ana tjetër do të kontribuonte në përmirësimin e performancës ekonomike duke liruar burimet që përndryshe do t'i kushtoheshin rritjes së fëmijëve, si dhe zvogëlimit të tendosjeve në infrastrukturë dhe mjedis.

Teoria “pesimiste” e gjurmon prejardhjen e saj tek Thomas Malthus.

Sipas kësaj teorie, në parim, një numër më i madh i popullsisë kërkon më shumë shtëpi, fabrika dhe infrastrukturë për të strehuar, punësuar dhe siguruar nevojat e tyre. Në afat të gjatë, një kapital i tillë mund të ndërtohet, por periudhat e rritjes së shpejtë të popullsisë mund të çojnë fare mirë në ulje të kapitalit për punëtor dhe në ulje të standardeve të jetesës. Kur rritja e popullsisë është e shpejtë, një pjesë e madhe e investimeve përdoret për të furnizuar nevojat e popullsisë në rritje në vend që të mundësojë një rritje të nivelit të provizionit për frymë.

Sidoqoftë, në fillim të viteve 1980 ekonomistët kishin filluar të refuzonin pikëpamjen pesimiste. Hulumtimet empirike kishin dobësuar rastin e pesimistëve; teoria ekonomike kishte filluar t'i jepte një rëndësi teknologjisë dhe akumulimit të kapitalit njerëzor në krahasim me faktorët kryesorë të vjetër të rritjes së kapitalit fizik; dhe teoria demografike filloi të shikohej në atë afatmesme dhe afatgjatë, ku efektet afatshkurtra të rritjes së popullsisë ka të ngjarë të jenë zbutur të paktën pjesërisht (Bloom, et al., 2001).

2.1.2. Teoria “optimiste”: Ndryshimi i popullsisë mund të nxisë rritjen ekonomike

Historia e kohëve të fundit ka hedhur më shumë dyshime mbi teorinë e pesimistëve. Në 30 vitet e fundit kur popullsia e botës është dyfishuar, të ardhurat për kokë banori janë rritur me rreth dy të tretat. Uria ka ndodhur, por qindra miliona njerëz nuk kanë vdekur nga uria; zia e bukës që ka ndodhur është shkaktuar kryesisht nga varfëria dhe mungesa e fondeve në mesin e një pjese të popullsisë për të blerë ushqim dhe jo nga ndonjë mungesë absolute e ushqimit (siç ka vënë në dukje Amartya Sen).

Përparimi teknologjik, si në bujqësi ashtu edhe në industri, ka qenë më i shpejtë se çdo herë tjetër në historinë njerëzore. Ka pasur risi po aq dramatike shoqërore dhe institucionale, në mënyrën se si njerëzit punojnë, standardin e arsimimit dhe shëndetit të tyre dhe masën në të cilën ata marrin pjesë në procesin politik. Në vend që të kufizohen nga burimet fikse, çmimet e shumë lëndëve të para janë në rënie afatgjatë dhe disa pjesë të ekonomisë po "materializohen" pasi njohuria bëhet një pasuri gjithnjë e më jetike.

Këto prirje kanë mbështetur pikëpamjet e një grupi "optimistësh të popullsisë", të cilët kanë kërkuar të promovojnë idenë se rritja e popullsisë mund të jetë një pasuri ekonomike. Simon Kuznets dhe Julian Simon, për shembull, argumentojnë (veçmas) se me rritjen e popullsisë, rritet edhe stoku i zgjuarsisë njerëzore. Shoqëritë më të mëdha - me aftësinë për të përfiturat nga ekonomitë e shkallës - janë më të pozicionuara për të zhvilluar, shfrytëzuar dhe shpërndarë rrjedhën e shtuar të njohurive që marrin.

Optimistët, duke hedhur poshtë tendencat alarmante të teorisë së pesimistëve, nuk ishin dogmatikë për ndikimet pozitive të rritjes së popullsisë. Në vend të kësaj, ata morën një pamje më të gjerë, duke sugjeruar se një mori faktorësh të jashtëm ishin përgjegjës për pasojat e rritjes së popullsisë. Këta faktorë mund të kenë pasoja ekonomike pozitive ose negative - siç tha TN Srinivasan: "Shumë nga pasojat e dyshuara dëmtuese rezultojnë më shumë nga politikat dhe institucionet e papërshtatshme sesa nga rritja e shpejtë e popullsisë". Ky zgjerim i diskutimit mbi rritjen e popullsisë përfundimisht çoi në neutralizimin e popullsisë që doli si pikëpamja dominuese në debatin demografik (Bloom, et al., 2001).

2.1.3. Teoria “neutrale”: Ndryshimi i popullsisë nuk ka efekt të rëndësishëm në rritjen ekonomike

Në "Hetimin e tij mbi Natyrën dhe Shkaqet e Pasurisë së Kombeve" (1776), Adam Smith pyeti pse disa vende ishin më të pasura se të tjerat. Ai e gjeti përgjigjen e tij në ndarjen e punës, e cila i lejoi punëtorët të bëhen më produktivë duke i përmirësuar aftësitë e tyre në detyra gjithnjë e më të specializuara. Vitet e fundit, ekonomistët duke marrë parasysh efektet ekonomike të ndryshimit demografik kanë qenë më të interesuar për Adam Smithin dhe idenë e tij për fuqinë e tregut, sesa për parashikimet e tmerrshme të Thomas Malthus për popullsinë. Shumica e analizave ekonomike kanë ekzaminuar korrelacionin statistikor midis popullsisë dhe rritjes ekonomike dhe kanë gjetur pak lidhje të rëndësishme. Megjithatë vendet me popullsi në rritje të shpejtë kanë tendencë të kenë ekonomi në rritje më të ngadaltë, ky korrelacion negativ zakonisht zhduket (apo edhe ndryshon drejtimin) pasi faktorë të tjerë të tillë si madhësia e vendit, hapja ndaj tregtisë, arritja arsimore e popullsisë dhe cilësia e institucioneve civile dhe politike merret parasysh. Me fjalë të tjera, kur kontrollohet për faktorë të tjerë, ka pak dëshmi që rritja e popullsisë pengon rritjen ekonomike. Ky rezultat duket se justifikon një pikëpamje të tretë, neutralizimin e popullsisë.

Teoria neutrale është pikëpamja dominuese sot. Allen Kelley ka sugjeruar se neutralizmi i popullsisë ka qenë në fakt shkolla mbizotëruese në të menduarit midis akademikëve për rritjen e popullsisë gjatë gjysmëshekullit të fundit.

Kelley citon tre fusha kryesore kërkimore që ndikuan në rritjen e neutralizmit të popullsisë në vitet 1980:


- *Burimet natyrore*: Shterimi i burimeve natyrore nuk u prek aq shumë nga rritja e popullsisë sa mendonin Pesimistët. Teknologjia, ruajtja dhe shpërndarja efikase e tregut të burimeve luajnë të gjitha një rol në ruajtjen e burimeve natyrore dhe të ardhurat për kokë banori janë treguar të jenë një përcaktues kyç i ofertës dhe kërkesës për këto burime.

- *Kursimi*: Ndikimi në rritjen ekonomike të reduktimit të kursimeve si rezultat i rritjes së popullsisë nuk mbështetet nga studimet.

- *Diversifikimi i burimeve*: Aty ku Pesimistët kishin menduar se rritja e popullsisë do të çonte në një devijim të burimeve nga formimi i kapitalit produktiv fizik në zona më pak produktive ekonomisht siç janë arsimit dhe programet e mirëqenies sociale, studimet e shumë vendeve treguan se kjo në fakt nuk ndodhi në një masë të madhe (Bloom, et al., 2001).

2.2. Ndikimi kulturor në rritjen ekonomike

Kultura mund të studiohet përmes tre elementeve kryesore: etnisë, gjuhës dhe fesë. Kjo mund të shpjegohet me faktin se përkatësia etnike ofron një bazë gjenetike në të cilën sjelljet socio-ekonomike midis grupeve të njerëzve mund të diferencohen lehtësisht, gjuha është një mjet efektiv komunikimi dhe feja mund të sigurojë njohuri për karakteristikat e kulturë (Boldea, 2012).



Burimi: George Julian, 2019

Figura 1: Gjuhët më të folura në botë, 2019

Një vështrim në histori zbulon se shpërndarja e folësve të gjuhëve ka reflektuar shpërndarjen e fuqisë ekonomike në botë. Latinishtja, për shembull, ishte një gjuhë universale në Evropë gjatë Mesjetës dhe Rilindjes. Frëngjishtja dikur njihej si gjuha universale e diplomacisë, dhe anglishtja sot thuhet shpesh se plotëson një rol të tillë në tregtinë botërore. Gjatë kohës së Bashkimit Sovjetik, rusishtja ishte gjuha që mendohej në shumicën e vendeve. Rënia e fuqisë ruse është shoqëruar me një rënie paralele të përdorimit të rusishtes si gjuhë e dytë.

Që nga fundi i shekullit të njëzetë, fuqia ekonomike e Kinës ka stimuluar mësimin e gjuhës kineze në vendet e tjera. Megjithatë, asnjëra prej tyre nuk ka qenë në gjendje të bëhet një gjuhë universale. Me qëllim që komunikimi ndërkombëtar të jetë më i thjeshtë, përpjekje të shumta janë bërë gjithashtu për të krijuar gjuhë artificiale gjatë shekujve të kaluar (Boldea, 2012).

2.3. Statistikat mbi zhvillimet sociale dhe ekonomike në Kosovë dhe vendet tjera të EJL-së

Europa Juglindore është një përcaktim relativisht i fundit i politikës kryesisht për shtetet e Ballkanit (Lampe, 2005).

Ky nën kapitull analizon zhvillimet sociale dhe ekonomike në Kosovë në krahasim me vendet e tjera të Europës Juglindore, në mënyrë që të identifikohen dallimet dhe burimet e mangësive.

Kosova, edhe përkundër rritjes së BPV për kokë banori nga 2,935 EUR në 3,566 EUR gjatë periudhës 2013-2017, kategorizohet si 'low-middle income country'¹. Gjatë kësaj periudhe referuese 2013-2017, rritja më e lartë vjetore ishte prej vitit 2014 në vitin 2015, përkatësisht në vlerë prej 6.2%.

Norma e rritjes së BPV për kokë banori është më e madhe në Kosovë krahasuar me vendet e rajonit, indikator ky i cili tregon se Kosova ka trend rritës më të shpejtë sesa vendet tjera në zhvillim. Poashtu, me këtë nivel të rritjes Kosova do të mund të arrijë më shpejtë vendet e zhvilluara sesa shtetet tjera, të cilat janë në nivel të njejtë të zhvillimit me Kosovën.

Në krahasim me vendet e rajonit si Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, Kosova ka BPV për kokë banori më të ulët. BPV-në për kokë banori më të lartë nga vendet e rajonit por që janë anëtare të Bashkimit Europian e ka Bullgaria me 7,414 EUR, Rumania me 9,981 EUR dhe Kroacia e cila në vitin 2017 sipas Bankës Botërore kishte BPV për kokë banori prej 12,271 EUR. (Divizioni i Strategjive Kombëtare, 2018).

¹ Sipas Bankës Botërore, vendet me të ardhura të mesme të ulëta konsiderohen ato shtete të cilat kanë BPV për kokë banori në kufirin \$996 - \$3,895.

Tabela 2: BPV për kokë banori në vendet e rajonit gjatë vitit 2017, 2020

	Kosova	Shqipëria	Maqedonia	Serbia	Mali i Zi	Bulgaria	Rumania	Kroacia
2017	3,566	4,188	5,024	5,446	7,079	7,414	9,981	12,271
2020	3,722	4,635	5,888	6,813	6,831	8,866	11,4612	12,290

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Banka Botërore

Ngjajshëm me Kosovën, edhe shtetet e tjera të Europës Juglindore (EJL) kanë pasur rritje pozitive ekonomike gjatë kësaj periudhe, megjithëse në një normë më të ulët se Kosova. Në vitin 2017, mesatarja e normës së rritjes ishte 2.9%, ku Kosova dhe Mali i Zi kryesojnë me normën më të lartë, prej 4.2% dhe 4.3%. Ndërsa shteti me përqindjen më të ulët të rritjes ishte Maqedonia me 0%. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, rritja ekonomike në këto shtete ishte më e ngadalësuar gjatë vitit 2017. Në rastin e Maqedonisë kjo ndodhi për shkak të jo-stabilitetit politik në vend, ndërsa në Serbi për shkak të motit të ftohtë që pati ndikim në produktet bujqësore dhe sektorin e ndërtimitarisë. Në Kosovë, Shqipëri dhe Mal të Zi rritja ishte më e lartë përkrahur nga rritja ekonomike e partnerëve tregtarë, ngritja e çmimeve bazë të mallrave dhe zbatimi i projekteve të mëdhenj investues (Divizioni i Strategjive Kombëtare, 2018).

Ndërsa në vitin 2020 në secilin vend ka pasur rritje të BPV për kokë banori krahasuar me vitin 2017, përveç në Mal të Zi ku nga 7,079 EUR ka rënë në 6,831 EUR.

Rajoni vazhdon të mbetet prapa në shumë tregues ekonomikë në raport me Bashkimin Europian, nga nivelet e ulëta të produktit të përgjithshëm të brendshëm bruto (PBB) për frymë. Pasojat e ngadalësimit të progresit ekonomik në shumë prej vendeve të rajonit kanë rezultuar në ngushtimin e mundësive ekonomike për shumë, dhe për rrjedhojë, situata ekonomike e rajonit është një nga arsytet e shumta që kontribuon në migrim. Nëse rajoni do të krijojë rritje të qëndrueshme ekonomike dhe perspektiva më të mira punësimi, vendet do të duhet të vazhdojnë

përpjekjet për të kaluar drejt produktivitetit më të lartë dhe aktiviteteve të avancuara ekonomike. Kjo do të kërkojë forcimin e bazës së kapitalit njerëzor dhe përpjekjet e vazhdueshme drejt përmirësimit të klimës institucionale/qeverisje dhe të investimeve (Omic & Handeland, 2021).

2.3.1. Puna dhe Punësimi në vendet e EJJ-së

Rritja ekonomike, papunësia janë disa nga variablat më të rëndësishëm që tregojnë ecurinë e një ekonomie. Cilësia e marrëdhënies ndërmjet këtyre variablave është jashtëzakonisht e rëndësishme gjatë zbatimit të politikave ekonomike (Dayıoğlu & Aydin, 2020).

Ndryshimi në GDP mund t'i atribuohet tre faktorëve, përkatësisht ndryshimeve në punësim, kohës mesatare të punës (orët e punës për punëtor) dhe produktivitetit për orë (GDP për orë të punuar, ose produktivitetit të dukshëm) (Burggraeve, et al., 2015).

Në vitin 2017, punësimi në shumicën e vendeve të rajonit arriti më në fund të rikthehet në nivelet që ishte para krizes financiare globale. Në vendet e Ballkanit Perëndimor u krijuan rreth 230,000 vende pune gjatë periudhës 12 mujore deri në Qershor 2017, ku punësimi u rrit mesatarisht me 3.8 përqind.

Vendet e punës u rritën më shpejt në Kosovë, ku punësimi u rrit me 8.5 përqind, i mbështetur nga rritja ekonomike dhe programi për përshpejtimin e investimeve publike; vendet e reja të punës u krijuan në sektorë të ndryshëm, si ndërtimi, prodhimi, tregtia me pakicë dhe shumicë, strehimi dhe bujqësia. Në Serbi, punësimi u rrit me 4.3 përqind pavarësisht sezonit të varfër bujqësor dhe ngadalësimit të rritjes ekonomike në përgjithësi. Sezoni i mbarë turistik dhe përshpejtimi i projekteve të ndërtimit në Malin e Zi nxitën hapjen e vendeve të reja të punës (me 3.5 përqind). Ndërsa në rritjen e punësimit me 3,4 përqind në Shqipëri kontribuan sektori i shërbimeve dhe industria, si dhe sipërmarrësit e vetëpunësuar. Rritja e punësimit në IRJ të Maqedonisë (2.7 përqind) ka ardhur kryesisht nga tregtia me shumicë dhe pakicë, konsumi privat, duke u ndjekur nga transporti, magazinimi dhe prodhimi industrisë përpunuese. Reformat e fundit në tregun e punës në

Bosnjë dhe Hercegovinë sollën një rritje të punësimit me 1.8 përqind, pas humbjes së vendeve të punës në 2016. Pavarësisht kësaj, Bosnje Hercegovina është i vetmi vend i Ballkanit Perëndimor ku punësimi nuk ka recuperuar ende nivelin që kishte para krizës; norma e punësimit në këtë vend është 8 përqind më e ulët se në vitin 2008 (Vostroknutova & Hernandez, 2017).

Pjesëmarrja në fuqinë punëtore u rrit në disa vende, megjithëse ajo është ende jashtëzakonisht e ulët, sidomos për femrat. Të gjitha vendet, me përjashtim të Bosnjë-Hercegovinës, përjetuan norma më të larta të pjesëmarrjes në fuqinë punëtore. Në Bosnjë-Hercegovinë, kjo normë ra në 42.6 përqind, duke ia kaluar në këtë mënyrë edhe Kosovës e cila kishte normën më të ulët prej 43 përqind (Vostroknutova & Hernandez, 2017).

Tabela 3: Rritja e punësimit në %, 2018


	Gjinia		Moshë			
	Total Meshkuj	Femra	15–24	25–54	55–64	
EJL	1.1	0.9	1.4	6.7	0.1	2.1
Shqipëria	3.3	1.6	5.4	24.6	-2.7	10.0
Bosnia dhe Hercegovina	0.8	1.2	0.2	12.8	0.0	0.9
Mali i Zi	3.3	4.8	1.4	28.2	0.0	4.4
Maqedonia	2.1	1.4	3.0	-6.2	1.4	4.4
Serbia	0.5	0.9	0.1	1.8	1.4	-1.1
Kosova	-4.5	-4.4	-4.7	-20.1	-2.7	-0.7

Burimi: Banka Botërore, 2019

Me përjashtim të Serbisë, rritja e shkallës së punësimit ishte më e lartë për meshkujt sesa për femrat; dhe rënia e shkallës së papunësisë së meshkujve ishte më e madhe sesa në nivelin e femrave në të gjitha vendet, përveç Kosovës dhe Shqipërisë. Kosova është i vetmi vend ku shkalla e papunësisë së meshkujve u rrit, ndërsa shkalla e papunësisë së femrave u ul margjinalisht. Në Shqipëri niveli i papunësisë ishte dy herë më i lartë sesa rritja e nivelit të meshkujve. Kosova qëndron në ulje të konsiderueshme të shkallës së pasivitetit

të meshkujve dhe rritje të shkallës së papunësisë. Bosnja dhe Hercegovina është i vetmi vend ku është rritur pasiviteti i meshkujve (The World Bank and the WIIW, 2019).

Pas situatës pandemike në vitin 2019, tregu i punës filloi të rimëkëmbet në fund të vitit 2020, mirëpo prapë ai mbetet i brishtë duke pasur parasysh valët e ripërtëritura të pandemisë dhe tërheqjen graduale të masave mbështetëse të qeverisë. Shkalla e punësimit në Ballkanin Perëndimor (për moshat 15 vjeç e lart) për katër tremujorë mbeti kryesisht e njëjtë në qershor 2021 në 45 përqind, krahasuar me vitin 2020. Rënia më e madhe e shkallës së punësimit u pa në Mal të Zi (4.2 pikë përqindje), ku mbylljet dhe ndalimet e udhëtimit shkaktuan një ndikim serioz në sektorin e turizmit. Ndërkohë, në Kosovë shkalla e punësimit është rritur për 1.2 pikë përqindjeje për shkak të fitimeve në punësimin formal.




Burimi: Të dhënat nga zyrat kombëtare të statistikave; përlllogaritje të stafit të Bankës Botërore.

Figura 2: Shkalla e punësimit, ndryshimi në % 2020-2021, 15+ vjet


Me 52.4 përqind, Shqipëria ka ende shkallën më të lartë të punësimit në rajon; në Kosovë, në ekstremin tjetër, vetëm rreth 30 përqind e popullsisë në moshë pune është e punësuar.

Përafërsisht 84,000 vende pune u humbën në gjysmën e parë të 2021 në Ballkanin Perëndimor, krahasuar me mesataren e vitit 2020, por një rimëkëmbje e madhe filloi që nga prilli. Në Serbi, pas një ecurie të ngadaltë në tremujorin e parë 2021, tregu i punës u rikthye përsëri në tremujorin e dytë 2021, duke shtuar më shumë vende pune se në vitin 2020. Rimëkëmbja ende nuk ka nderur tregun e punës në Mal të Zi: që nga shpërthimi i pandemisë, ka pasur një rënie të vazhdueshme në punësim, me rreth 40,000 vende pune të humbura që nga mesi i vitit 2020. Tregtia, ndërtimi dhe turizmi kanë marrë dëmin më të madh, megjithëse rimëkëmbja e turizmit gjatë verës pritet të rrisë punësimin. Në Maqedoninë e Veriut, punësimi u rikuperua në fund të vitit 2020 dhe vazhdoi gjatë gjithë vitit 2021, me gratë që kontribuan në rritje ndërsa kaluan nga papunësia në punë në sektorin e shërbimeve. Punësimi u rrit marginalisht në TM2 2021 në Shqipëri për shkak të punësimit në ndërtim dhe prodhim, ndërkohë që bujqësia vazhdoi të tkurret.



Burimi: Të dhënat nga zyrat kombëtare të statistikave; përlogaritje të stafit të Bankës Botërore

Figura 4: Shkalla e pasivitetit, 15+ vite, ndryshimi në përqindje 2021-21



Burimi: Të dhënat nga zyrat kombëtare të statistikave; përlogaritje të stafit të Bankës Botërore

Figura 3: Shkalla e papunësisë, 15+ vite, ndryshimi në përqindje 2020-21

Papunësia u rrit në gjysmën e parë të vitit 2021 në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Kishte 125,000

punëkërkues më shumë se në gjashtëmujorin e parë të 2020, nga të cilët dy të tretat ishin nga Serbia. Meqë disa nga programet e mbështetjes së qeverisë janë zvogëluar, shkalla e papunësisë në Serbi në gjysmën e parë të 2021 u rrit në 11.9 përqind (krahasuar me 9.2 përqind në të njëjtën periudhë të 2020). Me rënien gradualisht të mbështetjes, disa nga prodhuesit e mëdhenj në pronësi të huaj vendosën të mbyllnin aktivitetet e tyre në Serbi, duke rezultuar në pushime të konsiderueshme nga puna. Normat e papunësisë në Mal të Zi dhe Bosnje-Hercegovinë kanë ardhur gjithashtu në rritje në gjysmën e parë të 2021, përkatësisht me 4,6 dhe 2,2 pikë përqindje, krahasuar me një vit më parë.

Në Shqipëri, shkalla e papunësisë ra në 11.6 përqind në tremujorin e dytë dhe më në fund është shoqëruar me një rritje të shkallës së pjesëmarrjes në mbi 59 përqind—më e larta në rajon. Maqedonia e Veriut është i vetmi vend në rajon që ka regjistruar një rënie të vazhdueshme të shkallës së papunësisë gjatë gjithë krizës—shkalla e saj e papunësisë ra nën 16 përqind në tremujorin e dytë, më e ulëta që nga prezantimi i matjes në 2007. Megjithatë, kjo është pjesërisht për shkak të një rënie e shkallës së pjesëmarrjes dhe një rritje e pasivitetit (Figura 4) (World Bank Group, 2021).

Humbjet e vendeve të punës kanë prekur në mënyrë disproporcionale të rinjtë dhe gratë. Ndërsa shkalla mesatare e papunësisë në Ballkanin Perëndimor u rrit në 17.3 përqind, 1.5 pikë përqindjeje më shumë nga qershori 2020, papunësia e të rinjve u rrit në 37.7 përqind, me 5.4 pikë përqindjeje nga qershori 2020, duke përkeqësuar më tej perspektivat e punësimit të të rinjve. Mali i Zi regjistroi rritjen më të madhe të papunësisë tek të rinjtë, ndërsa as Maqedonia e Veriut nuk është kursyer. Vetëm në Shqipëri papunësia e të rinjve u ul në nën 20 përqind - niveli më i ulët në histori. Ndër ata që preken në mënyrë disproporcionale janë edhe të vetëpunësuarit dhe punëtorët me kontrata jo standarde.

Pothuajse gjysma e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor vazhdojnë ta shohin papunësinë si një nga sfidat më të rëndësishme për vendin (World Bank Group, 2021).

2.3.2. Varfëria në vendet e EJL-së

Varfëri do të thotë të jesh keq materialisht, socialisht dhe emocionalisht (Alcock, 1997). A janë në konflikt reduktimi i varfërisë dhe përsheptimi i rritjes? Apo janë plotësuese? Tradicionalisht, është shprehur se rritja e shpejtë është e keqe për të varfërit, sepse ata do të anashkalohen dhe marginalizohen nga ndryshimet strukturore të rritjes modern. Shqetësimet se përqendrimi i përpjekjeve për të ulur varfërinë do ta ngadalësojë normën e rritjes, paralelizon argumentet se vendet me pabarazinë më të ulët do të përjetojnë rritje të ngadalshme (Todaro, et al., 2018).

Ekzistojnë të paktën pesë arsye pse politikat e fokusuara në drejtim të reduktimit të nivelit të varfërisë nuk duhet të çojnë në një ritëm të ngadaltë të rritjes – dhe në të vërtetë mund të ndihmojnë për të përsheptuar rritjen.

Së pari, përhapja e varfërisë krijon kushtet në të cilat të varfrit nuk kanë qasje ndaj kredive. nuk janë në gjendje për të financuar arsimimin e fëmijëve të tyre, dhe, në mungesë të mundësive për investime fizike ose monetare, bëjnë shumë fëmijë si një burim për të siguruar anën financiare në pleqëri.

Së dyti, të pasurit në shumë vende bashkëkohore të varfra, në përgjegjësi nuk janë të njohur për kursime ose për dëshirën e tyre për të kursyer dhe investuar shuma të konsiderueshme të të ardhurave të tyre në ekonominë lokale.

Së treti, të ardhurat e ulëta dhe niveli i ulët i jetesës për të varfrit, të cilat janë manifestuar në shëndet të dobët, kequshqyerje dhe mungesë arsimimi, mund të ulin produktivitetin e tyre ekonomik dhe në këtë mënyrë të çojnë drejtpërdrejt dhe jodrejtpërdrejt në një ekonomi me rritje më të ngadaltë.

Së katërti, rritja e nivelit të të ardhurave e të varfërve do të stimulojë një rritje të përgjithshme në kërkesën për produktet e domosdoshme të prodhuara në vend, si ushqim dhe veshmbathje, ndërsa të pasurit kanë tendencë për të shpenzuar më shumë nga të ardhurat e tyre të tjera në mallra luksi të importuara.

Së pesti, një reduktim i varfërisë masive mund të stimulojë zgjerimin e shëndoshë ekonomik, duke vepruar si një material i fuqishëm dhe si nxitës psikologjik për pjesëmarrje të gjerë publike në procesin e zhvillimit. Në të kundërt, pabarazitë e mëdha e të ardhurava dhe varfëria absolute e konsiderueshme, mund të veprojnë si një pengesë psikologjike në

progresin ekonomik (Todaro, et al., 2018).

Vlerësimet më të fundit sistematike të varfësisë (të disponueshme deri në fillim të vitit 2014) tregojnë se në vitin 2010 rreth 1,22 miliardë njerëz jetonin me më pak se 1,25 \$ në ditë dhe se rreth 2,36 miliardë jetonin me më pak se 2 \$ në ditë. Numri i njerëzve që jetojnë me 1,25 \$ të ardhura në ditë ka rënë nga rreth 1,94 miliardë në vitin 1981 – një reduktim prej 37 % në numër. Rënia e numrit të atyre që jetojnë me më pak se 2 \$ në ditë është shumë më i vogël – por kjo rënie modeste ndodhte për shkak të njerëzve të ardhurat e të cilëve ishin më tepër se 1,25 \$ në ditë, edhe pse mbetën sërish nën 2 \$ në ditë. Këto arritje në zvogëlimin e numrit të njerëzve që jetojnë në varfëri janë edhe më mbresëlënëse kur kemi parasysh se popullsia e botës është rritur me 2,39 miliard njerëz (52%) ndërmjet viteve 1981 dhe 2010 (vlerësimet e OKB-së) (Todaro, et al., 2018).

Sipas (Lee & Vivarelli, 2006) sa i përket punësimit dhe shpërndarjes së të ardhurave, një mesazh i qartë që del nga shumë studime është se teknologjia ka shumë rëndësi.

Rritja ekonomike, krijimi i vendeve të punës, dhe inflacioni i ulët nxorren shumë njerëz nga gjendja e varfërisë. Shkalla mesatare e varfërisë për Shqipërinë, IRJ e Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë vlerësohet se ka rënë me afërsisht 1 pikë përqindje në vitin 2017 krahasuar me një vit më parë, duke arritur në një nivel të parashikuar prej 23.6 përqind. Kjo nënkupton se rreth 124,000 njerëz në këto vende nuk jetojnë më në varfëri. Në mënyrë që të ruajnë arritjet e fundit në drejtim të përmirësimit të mirëqënies, vendet e rajonit duhet të vazhdojnë të gjenerojnë mundësi të reja punësimi si dhe të rrisin të ardhurat nga puna për të reduktuar varësinë nga transfertat sociale (Vostroknutova & Hernandez, 2017).

Varfëria në rajon pritet të vazhdojë të zvoglohet, megjithëse vendet do të kenë ritme të ndryshme të uljes së saj. Rezultatet e zvogëlimit të varfërisë në secilin vend do të varen nga modelet e rritjes ekonomike, përmirësimet në tregun e punës dhe numri i njerëzve afër kufirit të varfërisë. Për këtë arsye, rreziqet me efekt në kahun negativ të rritjes ekonomike, sfidat e krijuara nga konsolidimi fiskal, shkalla e lartë e papunësisë dhe pasivitetit, dhe

ekspozimi ndaj fatkeqësive natyrore do të vijojnë të rrisin ekspozimin ndaj varfërisë (Vostroknutova & Hernandez, 2017).

